

VENDIM
Nr.134, datë 18.2.2005

**PËR NGRITJEN E SEKRETARIATIT TË KOMITETIT KOORDINUES TË
MINISTERIALIT TË MBROJTJES SË EUROPËS JUGLINDORE (SEDM-CC) DHE
TË KOMITETIT DREJTUES POLITIKO-USHTRAK/FORCËS PAQERUAJTËSE
SHUMËKOMBËSHE TË EUROPËS JUGLINDORE (PMSC/MPFSEE) NË
SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të marrëveshjes dhe të protokollit shtesë “Për krijimin e Forcës Shumëkombëshe të Europës Juglindore”, ratifikuar me ligjin nr.8544, datë 4.11.1999, të nenit 21 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Sekretariatit të Komitetit Koordinues, ad-hoc, të Ministerialit të Mbrojtjes së Europës Juglindore (SEDM/CC) dhe të Komitetit Drejtues Politik-Ushtrarak/Forcës Paqerujtëse Shumëkombëshe të Europës Juglindore (PMSC/MPFSEE) në Shqipëri, në varësi administrative të Ministrisë së Mbrojtjes, për bashkërendimin e veprimtarisë së SEDM/CC dhe të PMSC/MPFSEE dhe për zbatimin e vendimeve politike që do të marrin e të programeve që do të miratojnë. Sekretariati i SEDM/CC dhe i PMSC/MPFSEE të funksionojë për një periudhë dyvjeçare, ku veprimtaria parapërgatitore të fillojë më 1 mars 2005, ndërsa veprimtaria zyrtare më 1 korrik 2005, dhe të përfundojë më 31 korrik 2007.

2. Sekretariati i SEDM/CC dhe i PMSC/MPFSEE të ketë 11 veta dhe të përbëhet nga personel, civil e ushtarak, i Ministrisë së Mbrojtjes, si më poshtë vijon:

- a) Kryetari të jetë civil;
- b) Këshilltari politik të jetë civil;
- c) 2 specialistë të jenë civilë;
- ç) Shefi i Sekretariatit të jetë ushtarak;
- d) Oficeri i shtabit për operacionet;
- dh) Oficeri i shtabit për logjistikën;
- e) Nëpunësi i protokollit të jetë ushtarak;
- ë) Përgjegjësi i administratës të jetë ushtarak;
- f) Nëpunësi i financës të jetë ushtarak;
- g) Përkthyesi i gjuhës angleze të jetë ushtarak ose civil.

Personeli i Sekretariatit përzgjidhet dhe emërohet nga Ministri i Mbrojtjes. Personelit të punësuar, ad-hoc, në këtë Sekretariat t’i ruhet pozicioni i vendit të punës së mëparshme, pas përfundimit të afatit të funksionimit të këtij Sekretariati.

3. Ministria e Mbrojtjes të sigurojë mjediset dhe pajisjet e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë dhe për funksionimin e Sekretariatit.

4. Kryetari, shefi i Sekretariatit, oficeri i shtabit për operacionet, oficeri i shtabit për logjistikën, oficeri i shtabit për protokollin dhe një specialist civil të jenë në detyrë të përhershme dhe ta fillojnë detyrën më 1 mars 2005, ndërsa pjesa tjetër e personelit më 1 korrik 2005.

5. Pagat e personelit të Sekretariatit të jenë të njëjta me pozicionet e shërbimit civil në administratën publike, si më poshtë vijon:

- a) Kryetari me atë të drejtorit të drejtorisë;
- b) Punonjësit civilë me atë të specialistit të nivelit të mesëm;
- c) Ushtarakët sipas gradës.

Ushtrakët aktivë, të cilët bien në pagë për shkak të emërimit në funksionet e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, trajtohen me shtesë “ruajtje page” gjatë kohës së qëndrimit në këtë detyrë.

6. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

7. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e vitit 2005, zëri “Mallra e shërbime”, t’i shtohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve për organizimin e takimeve e të veprimtarive të tjera, brenda dhe jashtë vendit.

8. Fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

9. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano